



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT

DPSUMK

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 2, Tiranë

Tel/Fax + 4 259 333

Nr. Prot.

Tiranë, më ____/____/2008

URDHËR

Nr. 568 Datë 22 /12/ 2008

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PER PRODUKTET USHQIMORE PER
PERDORIME USHQIMORE TE VEÇANTA"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, ligjit Nr. 9863, dt. 28.01.2008 "Për Ushqimin", nenit 76 të ligjit Nr. 9590, dt. 27.07.2006 "Per ratifikimin e Marreveshjes se Stabilizim Asocimit ndermjet Republikes se Shqiperise dhe komuniteteve Europiane e Shteteve te tyre anetare" dhe VKM Nr. 463 dt. 05.07.2006 "Per miratimin e planit kombetar per zbatimin e Marreveshjes se Stabilizim Asocimit" i ndryshuar:

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores " Për produktet ushqimore per perdorime ushqimore te veçanta" bashkëlidhur këtij Urdhëri.
2. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithëshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

JEMIN GJANA

RREGULLORE
“PER PRODUKTET USHQIMORE PER PERDORIME
USHQIMORE TE VECANTA”

1. Kjo rregullore ka te beje me ushqimet per perdorime ushqimore te vecanta.
- 2.(a) Ushqimet per perdorim ushqimor te vecante jane ato ushqime te cilat ne saje te perberjes se tyre ose procesit te vecante (specifik) te prodhimit, dallohen qarte nga ushqimet per konsum te zakonshem, te cilat jane te pershtatshme per qellimet e tyre ushqimore te deklaruar dhe qe tregtohen ne menyre te tille qe te tregojne kete pershtatshmeri.
(b) Ushqimet per perdorim ushqimor te vecante duhet te permbushin kerkesa te vecante ushqimore:
 - (i) per nje kategori te percaktuar personash te cilet kane çrregullim ne procesin tretes ose metabolizem
 - (ii) per nje kategori personash te cilet jane ne kushte fiziologjike te vecanta dhe qe mund te perfitojne dobi te veçanta nga konsumimi i kontrolluar i substancave te caktuara qe ndodhen ne ushqime, ose
 - (iii) per bebe dhe femije me te rritur, ne gjendje te mire shendetesore
3. Produktet per te cilat behet fjale ne piken (2)(b)(i) dhe (ii) mund te cilesohen “dietike” ose “diete”.
4. Ne etiketim, prezantim dhe reklamim te ushqimeve per konsum normal nuk lejohet:
 - (a) perdorimi i mbiemrit “dietik” ose “diete” vetem ose lidhur me fjale te tjera per te emertuar keto ushqime
 - (b) te gjitha shenjat ose ndonje paraqitje tjeter qe krijon pershtypjen se behet fjale per ndonje nga produktet e permendura ne piken (2).
5. Natyra ose perberja e produkteve qe permenden ne piken (2) duhet te jete e tille qe ato te jene te pershtateshme per perdorim ushqimor te vecante.
6. Produktet e permendura ne piken (2) duhet te perputhen me kerkesat e detyrueshme te zbatueshme per ushqimet per konsum normal, perjashto ndryshimet e bera ne to per te siguruar perputhshmerine e tyre me perkufizimet e dhena ne piken (2).
7. Kerkesat e veçanta per grupet e ushqimeve per perdorime ushqimore te vecanta te dhena ne aneksin 1 percaktohen me rregullore te vecante.
Keto rregullore te vecanta permbajne ne vecanti:
 - (a) kerkesa thelbesore mbi natyren apo perberjen e produkteve
 - (b) dispozita ne lidhje me cilesine e lendeve te para

- (c) kërkesa higjienike
- (d) ndryshime të lejueshme brenda kuptimit të pikës 6;
- (e) listen e aditiveve
- (f) kërkesa mbi etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin
- (g) procedurat e marrjes së kampioneve dhe metodat e analizave të nevojshme për të zbuluar përputhshmerinë me rregulloret e vecanta.

8. Rregullat për përdorimin e termave në lidhje me:

- reduktimin ose mungesën e përmbajtjes së Na ose të kriprave (klorur Na, kripe tavoline)

- mungesën e glutenit

te cilat mund të përdoren për të përshkruar produktet e përmendura në pikën (2), përcaktohen me rregullore të vecanta.

9. Menyra dhe metodat e përdorura për etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e ushqimeve që përmenden në pikën (2) nuk duhet të atribuojnë veti për parandalimin, trajtimin ose mjekimin e sëmundjeve në njëzë.

9.1. Paragrafi 1 nuk ndalon personat që kanë kualifikime në mjekësi, nutricionë ose farmaci të japin informacion ose rekomandime në lidhje me parandalimin, trajtimin ose mjekimin e sëmundjeve nga përdorimi i këtyre produkteve.

10. Produktet për përdorim ushqimor të vecanta duhet të plotësojnë kërkesat e rregullores “për etiketimin e produkteve ushqimore”, sipas kushteve të mëposhtme:

(a) Emri me të cilin shitet produkti duhet të shoqërohet me një tregues të karakteristikave të tij ushqimore të vecanta; megjithatë në rast se kemi të bëjmë me produkte për të cilët bëhet fjalë në pikën (2) (b) (iii), kjo referencë duhet të zëvendësohet me qëllimin e përdorimit të këtij ushqimi.

(b) Etiketimi i produkteve të cilat nuk mbulohen nga rregullore të vecanta, duhet të përfshijë:

(i) Tregues të vecanta për përberjen çilesore e sasiore ose procesin e prodhimit, që i japin produktit karakteristika ushqimore të vecanta.

(ii) Vlerën e përmbajtjes së energjisë të shprehur në kilo-xhaul dhe kilo-kalori dhe përmbajtjen e karbohidrateve, proteinave dhe yndyrnave për 100gr ose 100 ml produkt dhe kur është e mundur, për sasi të caktuara të produktit për konsum.

Nqs vlera e energjisë është më pak se 50 kilo-xhaul (12 kilo-kalori) për 100 gr ose 100 ml produkt, këto të dhëna mund të zëvendësohen me fjalet “vlera e energjisë më pak se 50 kilo-xhaul (12 kilo-kalori) për 100g ose nga fjalet “vlera e energjisë më pak se 50 kilo-xhaul (12 kilo-kalori) për 100 ml”

11. Produktet e percaktuara ne piken (2) lejohet te shiten ne tregun e pakices ne forme te para pakeluar dhe paketimi duhet ti mbuloje plotesisht keto produkte .
Perjashtohen nga kjo kerkese, produktet qe shiten ne tregetine me pakice, me kusht qe produkti te shoqerohet me te dhenat e percaktuara ne piken 10, ne momentin e shitjes.

12. Me qellim qe te sigurohet nje kontroll zyrtar efikas per ushqimet per perdorim ushqimor te vecante, te cilat nuk bejne pjese ne grupet e listuara ne Aneksin 1, duhet te zbatohen kerkesat specifike te meposhtme:

1. kur nje produkt tregtohet per here te pare, prodhuesi, ose importuesi i tij, duhet te lajmeroje Autoritetin Kompetent (AK) ku produkti tregtohet, duke paraqitur paraprakisht nje model te etiketes se perdorur. Kur i njeiti produkt tregtohet me pas ne nje shtet tjetër, prodhuesi ose importuesi duhet ti paraqese autoritetit kompetent te ketij shteti te njejtin informacion.
2. Atehere kur eshte e nevojshme autoriteti kompetent i kerkon prodhuesit ose importuesit, te paraqese te dhena shkencore si dhe te dhena mbi perputhshmerine me piken (2) sebashku me informacionin e pikes 10 (b)(i).

13. AK nuk duhet te bllokoje ose kufizojë tregetine, e produkteve te percaktuara ne piken (2), dhe qe jane ne perputhje me kete rregullore dhe me rregullore te tjera qe trajtojne perberjen, prodhimin, specifikimet, paraqitjen ose etiketimin.

14. Kur AK ka te dhena te hollesishme qe nje ushqim i prodhuar per perdorime ushqimore te vecanta, qe nuk ben pjese ne grupet e listuara ne aneksin I, nuk perputhet me kerkesat e pikes (2), ose demton shendetin e njeriut, dhe megjithese ky ushqim qarkullon lirshem ne nje ose me shume vende te tjera, mund te pezulloje perkohesisht ose te bllokoje tregetin e ketij produkti brenda territorit te tij. Per kete informon autoritetet kompetente te vendeve te tjera duke dhene arsyen e ketij pezullimi.

16. Për kategoritë e substancave te shtuara per qellime ushqimore te vecanta ne produktet ushqimore per perdorim ushqimore te vecanta, te listuara ne aneksin II te kesaj rregullore, mund te perdoren ne prodhimin e produkteve ushqimore per perdorim ushqimor te vecante vetem substancat kimike te çdo kategorie. Perdorimi i ketyre substancave duhet te jete konform kerkesave specifike, te percaktuara ne rregullore te vecanta.

17. Perdorimi i ketyre substancave ushqyese ne ushqimet per perdorim ushqimor te vecante duhet te rezultojë ne prodhimin e produkteve te sigurta qe plotesojne kerkesat ushqimore te vecanta per personat e percaktuar per t'u perdorur.

18. Per substancat shtese te listuara ne aneksin II qe perdoren per prodhimin e produkteve ushqimore per perdorim ushqimor te vecante, zbatohen kerkesat e rregulloreve te vecanta “ Mbi kriteret e pastertise”.

Per ato substanca te listuara ne aneksin II per te cilat kriteret e pastertise nuk jane te specifikuar nga rregullore te vecanta, dhe deri ne miratimin e kerkesave te tilla, do te zbatohen kriteret e pergjitheshme te pastertise te rekomanduara nga standarte kombetare.

ANEKSI I

Grupet e produkteve ushqimore per perdorime ushqimore te vecanta per te cilat kerkesat specifike jepen nga rregullore te vecanta:

1. formulat e infanteve dhe formulat rrjedhese
2. produktet e perpunuara me baze drithi dhe ushqimet per femije te vegjel dhe femije me te rritur
3. ushqimet qe perdoren ne dieta me energji te kufizuar per reduktimin e peshes
4. ushqimet dietike per qellime mjekesore te vecanta
5. ushqimet qe perdoren per te plotesuar harxhimet nga tendosjet e medha muskulare vecanerisht per sportistet
6. Ushqimet per personat qe vuajne nga diabeti.

ANEKSI II

Substancat qe mund te shtohen per qellime ushqyese te vecanta ne ushqime per perdorim ushqimor te vecante

Për qëllim të këtij Aneksi, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- “FSMP” nënkupton ushqime që mendohet të përdoren për qëllime ushqimore të veçanta për qëllime specifike mjekesore ;
- “ALL FPNU” nënkupton ushqime dietike për përdorime të vecanta lëndësh ushqyese përfshirë FSMP-në por duke përjashtuar formulat ushqimore të foshnjeve, formulat rrjedhëse, ushqime të prodhuara me bazë drithërash, dhe ushqime për fëmijë të menduara për foshnje dhe fëmijë më të rritur.

SUBSTANCA	Kushtet e përdorimit	
	ALL FPNU	FSMP
Kategoria 1. Vitaminat		
VITAMIN A		
- retinol	X	
- acetat retinoli	X	
- palmitat retinoli	X	
- beta-karoten	X	
VITAMIN D		
- kolekalciferol	X	
- ergokalciferol	X	
VITAMIN E		
- D-alfa-tokoferol	X	
- D-alfa-tokoferol polietilen glycol 1000 succinate	X	
- DL- alfa-tokoferol	X	
- acetat D-alfa tokoferol	X	
- acetat DL-alfa tokoferol	X	
- acid succinat D-alfa- tokoferol	X	
VITAMIN K		
- vitamine K ₁ (fitomenadion)	X	
VITAMIN B1		
- tiamin hidrokloride	X	
- mononitrat tiamin	X	

VITAMIN B2		
- riboflavin	X	
- riboflavin 5'-natrium fosfat,	X	
NIACIN		
- acid nikotink	X	
- nikotinamid	X	
ACID PANTOTENIK		
- D-pantotenat kalciumi	X	
- D-pantotenat natriumi	X	
- Dexpantenol	X	
VITAMIN B6		
- hidroklorid pirodoksini	X	
- 5'-fosfat pirodoksini	X	
- dipalmitat pirodoksini	X	
FOLATE		
- acidi fterolmonoglutamik	X	
- kalcium L-metilfolate	X	
VITAMIN B 12		
- cianokobalamin	X	
- hidrokobalamin	X	
BIOTIN (Vitamine)		
- D-biotin	X	
VITAMIN C		
- acid L-askorbik	X	
- natrium-L-askorbat	X	
- kalcium-L-askorbat	X	
- kalium-L-askorbat	X	
- L-askorbil 6-palmitat	X	
Kategoria 2. Mineralet		
BOR		
- acid borik	X	
- borat natriumi	X	
KALCIUM		
- karbonate	X	
- kloride	X	
- kripera te acidit citric	X	
- glukonate	X	

- glicerofosfate	X	
- laktate	X	
- kripera te acidit ortofosforik	X	
- hidrokside	X	
- okside	X	
- sulfate	X	
- amino acid chelate	X	
- pidolate	X	
MAGNEZ		
- acetate	X	
- karbonate	X	
- kloride	X	
- kripera te acidit citric	X	
- glukonate	X	
- glicerofosfate	X	
- laktate	X	
- kripera te acidit ortofosforik	X	
- hidrokside	X	
- okside	X	
- sulfate	X	
- magnesium L-aspartate		X
- amino acid chelate	X	
- pidolate	X	
HEKUR		
- karbonat ferros	X	
- citrat ferros	X	
- citrat amonium ferrik	X	
- glukonat ferros	X	
- fumarat ferros	X	
- natrium difosfat ferrik	X	
- laktat ferros	X	
- sulfat ferros	X	
- difosfat ferrik (pirofosfat ferrik)	X	
- saharat ferrik	X	
- hekur i lire (karbonil+elektrolitik+hidrogjen i reduktuar)	X	
- biglicinat ferros	X	
- hidroksid hekuri	X	
- pidolate hekuri	X	
- amino acid chelate	X	
BAKËR		
- karbonate kuprik	X	
- citrat kuprik	X	
- glukonat kuprik	X	

- sulfat kuprik	X	
- kompleks baker lisine	X	
- amino acid chelate	X	
JOD		
- jodur kaliumi	X	
- jodat kaliumi	X	
- jodur natriumi	X	
- jodat natriumi	X	
ZINK		
- acetate	X	
- kloride	X	
- citrate	X	
- glukonate	X	
- laktate	X	
- okside	X	
- karbonate	X	
- sulfate	X	
- amino acid chelate	X	
MANGANI		
- karbonate	X	
- kloride	X	
- citrate	X	
- glukonate	X	
- glicerofosfate	X	
- sulfate	X	
- amino acid chelate	X	
NATRIUM		
- bikarbonat	X	
- karbonat	X	
- kloride	X	
- citrate	X	
- glukonate	X	
- laktate	X	
- hidrokside	X	
- kripera te acidit ortofosforik	X	
KALIUM		
- bikarbonat	X	
- karbonat	X	
- kloride	X	
- citrat	X	
- glukonat	X	
- glicerofosfat	X	

- laktat	X	
- hidroksid	X	
- kripera te acidit ortofosforik	X	
SELEN		
- selenat natriumi	X	
- hidrogjen natrium selenit	X	
- selenit natriumi	X	
- maja e pasuruar	X	
KROMIUM		
- amino acid chelate	X	
KROMIUM (III) dhe heksahidratet e tyre		
- kloride	X	
- sulfate	X	
MOLIBDEN (VI)		
- molibdat amoniak	X	
- molibdat natriumi	X	
FLUOR		
- fluorur kaliumi	X	
- fluorur natriumi	X	
Kategoria 3. Aminoacidet		
- L-alanine	X	
- L-arginine	X	
- Acid L-aspartik		X
- L-citruline		X
- L-cisteine	X	
- Cistine	X	
- L-histidine	X	
- Acid L-glutamik	X	
- L-glutamine	X	
- Glicine		X
- L-isoleucine	X	
- L-leucine	X	
- L-lisine	X	
- Acetat L-lisin	X	
- L-metionine	X	
- L-ornitine	X	
- L-fenilalanine	X	
- L-proline		X
- L-treonine	X	
- L-triptofan	X	

- L-tirosine	X	
- L-valine	X	
- L-serine		X
- L-arginine L-aspartate		X
- L-lisine L-aspartate		X
- L-lisine L-glutamat		X
- N-acetil L-cisteine		X
- N-acetil L-metionine		X
Per amino acidet, persa kohe jane ne zbatim kriperat e Natriumit, Kaliumit, Kalciumit dhe Magnesit si dhe hidrokloridet e tyre mund te perdoren		X ne produktet qe perdoren per personat mbi 1 vjec
Kategoria 4. Karnitine dhe taurine		
- L-karnitine	X	
- hidrokloride L-karnitine	X	
- taurine	X	
- L-karnitine L-tartrate	X	
Kategoria 5. Nukleotidet		
- acid 5'-fosforik adenosine (AMP)	X	
- kripera natriumi te AMP	X	
- acid 5'-monofosforik citidine (CMP)	X	
- kripera natriumi te CMP	X	
- acid 5'-fosforik guanosine (GMP)	X	
- kripera natriumi te GMP	X	
- acid 5'-fosforik insosine (IMP)	X	
- kripera sodiumi te IMP	X	
- acid 5'-fosforik uridine (UMP)	X	
- kripera sodiumi te UMP	X	
Kategoria 6. Koline dhe inositol		
- koline	X	
- koline kloride	X	
- bitartrat koline	X	
- citrate koline	X	
- inositol	X	